



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Pro Medical" Sh.P.K. të datës 16.07.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "189 Mirëmbajtja dhe Servisimi i pajisjeve mjekësore në objektet KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-25-5129-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Pro Medical" Sh.P.K. të datës 16.07.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "189 Mirëmbajtja dhe Servisimi i pajisjeve mjekësore në objektet KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-25-5129-2-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Pro Medical" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 16.07.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "189 Mirëmbajtja dhe Servisimi i pajisjeve mjekësore në objektet KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-25-5129-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi 1 – “Posedimi i setit të kalibrimit për autoklavë Lisa 300 (LOT 1) Pra ju duke vendosur kërkesën maksimale si : 1. Për mirëmbajtje te autoklaveve operatori duhet te posedoje a.) setin për verifikimin e temperaturës dhe Presionit me certifikata valide te kalibrim i pajisjes b.) setin e kalibrimit te temperatures dhe presionit nga prodhuesi per autokllavet Lisa 300 per Lot 1. Kundërshtimi: Kërkesa që Operatorët Ekonomikë të posedojnë set kalibrimi të lëshuar nga vetë prodhuesi për modelin Lisa 300, është e kufizuar dhe e orientuar drejt një grupi të vogël OE-sh, kryesisht distributorë të autorizuar, duke përjashtuar pjesën tjetër të tregut që ofrojnë mirëmbajtje dhe kalibrim me pajisje ekuivalente”.

Pretendimi 2 – “Kërkesa për staf të trajnuar për Ceper CPR-Automatic (LOT 3) Kundërshtimi: Kërkesa për dëshmi të stafit të trajnuar specifikisht për pajisjen Ceper CPR-Automatic është joproporcionale dhe diskriminuese, sidomos në mungesë të informatave të qarta mbi numrin, rëndësinë apo përhapjen e këtyre pajisjeve në objektin e kontratës. Kërkesa për trajnim nga prodhuesi për një model të vetëm e përjashton në mënyrë të padrejtë operatorët që kanë trajnim të përgjithshëm për pajisje të ngjashme. Kërkesa jonë: Për sa më sipër, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të rishqyrtojë dhe modifikojë kriteret e përmendura në mënyrë që: 1. Të lejohet kalibrimi dhe testimi me pajisje ekuivalente, jo vetëm nga prodhuesi Lisa 300, 2. Të kërkohej trajnim i përgjithshëm për pajisje të ngjashme me CPR-Automatic dhe jo ekskluzivisht nga prodhuesi i modelit Ceper, nëse nuk ka arsyetim teknik të mbështetur në volum apo kompleksitet”.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, duhet sqaruar se kërkesa e DT për setit të kalibrimit për autoklavë Lisa 300 (LOT 1) si dhe kërkesa për staf të trajnuar për Ceper CPR-Automatic (LOT 3), janë kërkesa absolutisht të domosdoshme për realizimin efikas dhe efektiv të projektit. Në anën tjetër as parashtruesi nuk ka arritur që të prezantoj asnjë argument të vetëm sipas të cilit do të mund të konstatohej që kërkesat nuk janë në përputhje me LPP dhe/apo me qëllimin e DT.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e papabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP.


Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.07.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës.



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.